



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M

Nr. 50, datë 6.9.2017

**PËR MIRATIM TË VLERSIMIT PARAPRAK DHE MASA E SHPËRBLIMIT PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE QË PREKEN PËR EFEKT TË INVESTIMIT PUBLIK TË OBJEKTIT “NDËRTIM PARCELA TË REJA VARRESH”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 6.9.2017, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenin 23 pika 7, nenin 54 shkronja “dh”, nenin 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, i ndryshuar, VKM nr. 127, datë 23.3.2000 “Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, VKM nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, shkresat nr. 3210/1 prot, datë 13.5.2017, nr. 5954/1 prot, datë 10.8.2017, të ZVRPP Shkodër, projekt preventiv të miratuar, pasi shqyrtoi relacionin me pasqyrat përkatëse, me 27 vota pro,

V E N D O S I :

1. Të miratojë vlerën e shpronësimit tokë bujqësore (arë) për investime publike për objektin “Ndërtim parcela të reja varresh”, me vlerë **9.868.500** (nëntë milion tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekë, sipas pasqyrës bashkëngjitur.
2. Burimi i financimit në vlerën prej 9.868.500 lekë do të jetë nga Buxheti i Bashkisë Shkodër.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 6.9.2017

Shpallur në datën 7.9.2017

Sekretar i këshillit

Suel Hadri



KRYETAR

Xhondal BUSHATI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Pt. 14056 dt. 21.9.2017

Nr.954/1 Prot

Shkodër, me 18.09.2017

Lënda: Lidhur me vendimin Nr.50 datë 6.09.2017 të Këshillit të Bashkisë Shkodër.

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Shkodër.

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave funksionale të ligjit Nr.107/2016 dt.2.10.2016 "Për Prefektin", analizoi vendimin Nr.50 datë 6.09.2017 të Këshillit të Bashkisë Shkodër "Për miratim të vlerësimit paraprak dhe masa e shpërblimit për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të palujtshme, prone private që preken për efekt të investimit publik të objektit "Ndërtim parcela të reja varresh".

Prefekti në zbatim të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 23, pika 7, neni 54/dh, 55, pika 3, neni 56/4 i KPA, ligjit Nr.8561 date 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, prone private, për interes publik", i ndryshuar, ligjit Nr. 9244 date 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqesore" i ndryshuar, neni 13 dhe 14, ligjit Nr.8752 datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", i ndryshuar, neni 11/1, VKM Nr.410 datë 27.6.2012 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës", VKM Nr.127 datë 23.3.2000 "Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë prone private për interes publik", VKM Nr.89 dt. 3.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", nuk ju autorizohet të procedoni:

-për shkak të moszbatimit të dispozitës nenit 43-detajimi i fondeve dhe nenit 44-rishpërndarja e fondeve të ligjit nr.9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor" i ndryshuar, një element i rëndësishëm për vendim-marrjen e këshillit, në VKB është cituar vetëm buxheti i bashkisë Shkodër në përgjithësi pa asnjë detajim të mëtejshëm të domosdoshëm sipas akteve ligjore mbi financat në fuqi.

-sipas nenit 8 të ligjit Nr.9220 date 15.4.2004 "Për administrimin e shërbimit të varrimit", i ndryshuar, mungon një studim i plote i zones lidhur me projektin e zgjerimit të varrezave i cili miratohet nga këshilli bashkiak<sup>1</sup>.

Sjellim në vëmendje zbatimin e procedurave sipas akteve ligjore për procedurat e kalimit të tokës bujqesore në sipërfaqe ndërtimi përpara fillimit të investimit, sipas nenit 11/1 të ligjit Nr.8752 dt 26.03.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", i ndryshuar, pika 1 e kreut VII të VKM Nr.410 datë 27.6.2012, "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës".

Me respekt,

PREFEKTI

<sup>1</sup> Elemente mungues në këtë VKB

